



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Komuna Dragash/ Opština Dragaš/ Dragas Municipality



Kryetari i Komunës

02 Nr. 112/02-31914/21
Dt. 30.12.2021

Duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 shkronja f dhe nenit 62 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008),), nenit 57 të Statutit të komunës së Dragashit Nr. 06-103/1 i datës 11.09.2008, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR EMËRIMIN E DREJTORIT TË DREJTORISË SË ADMINISTRATËS

I

z.Vetim Ramadani, emërohet në pozitën e drejtorit të Drejtorisë së Administratës në Komunën e Dragashit.

II

Mandati i drejtorit do të fillon nga data 30.12.2021 dhe do të jetë i njëjtë me mandatin e kryetarit të Komunës. Emërimi i bërë me këtë vendim mund të rishqyrtohet në çdo kohë nga ana e kryetarit të Komunës.

III

Detyrat dhe përgjegjësit e drejtorit të Drejtorisë, janë të përcaktuara me Ligjin nr.-03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Statutin e Komunës së Dragashit dhe udhëzimet strategjike dhe politike të kryetarit të Komunës si dhe në pajtim me ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi.

IV

I emëruari do ti raportoj rregullisht kryetarit të Komunës për procesin e vendimmarrjes dhe funksionimin e Drejtorisë që e udhëheqë.

V

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Kabineti i Kryetarit, Zyra e Personelit dhe Drejtoria e Ekonomisë dhe Financave.

VI

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e nënshkrimit nga kryetari i komunës.

Kryetari i Komunës


Bexhet Xheladini

- Vendimi iu dërgohet:
 - Të emëruarit,
 - Drejtorisë për Ekonomi dhe Financa,
 - Sektorit të Personelit,
 - Arkivës së Kryetarit.





Republika e Kosovës Republika Kosova
/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine
Dragaš/Dragas Municipality



Kryetari i komunës

Data: _____

Dragash

10.12.2020
Dragaš/Dragas Municipality

Duke u bazuar në konkursin për ndarjen e bursave për student me nr 13/673 të datës 16.10.2020 për 100 bursa, si dhe rishpalljes së konkursit nr 13/741 të datës 24.11.2020 në raportin përfundimtar të komisionit për vlerësimin e kërkesave dhe marrjen e vendimit nga komisioni vlerësuese me nr të protokollit 13/772 të datës 05.12.2020, nenin 13 dhe 14 të Ligjit për Vetqeverisje Lokale, në rregullorën për Kushtet, kriteret dhe procedurat e ndarjes së subvencioneve-Bursave me numer të protokollit 01.Nr.060/0131587/1 të datës 24.12.2019, Kryetari i Komunës merrë këtë :

VENDIM

1. Të bëhet pagesa e studenteve sipas listës përfundimtare nga komisioni vlerësues
2. Pas kalimit të afatit të ankesave ,nuk ka pasur asnjë ankesë nga aplikuesit
3. Shuma për pages është 94 student x 350€ = 32,900€
4. Pagesa duhet të realizohet nga programi për subvencione dhe transfere si pas programit 21/621/16009/22200/00000/0111



Kryetari i Komunës
Shaban Shabani
Shaban Shabani